

Republika e Maqedonisë së Veriut
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE
DEMOGRAFISË DHE RINISË

Nr. 02-1651/1
20-02-2023

Shkup

Numri arkivor:

Data:

Duke u nisur nga përkushtimi për të garantuar respektimin e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, integritetit profesional, transparencës dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë miraton sa vijon:

POLITIKA E INTEGRITETIT

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë pranon integritetin si themelin e qeverisjes së mirë dhe një përgjigje strategjike të qëndrueshme ndaj korruptionit. Integriteti është thelbësor për prosperitetin ekonomik, social dhe shoqëror.

Me integritet nënkuftohet kryerja ligjore, e pavarur, e paanshme, etike, e përgjegjshme dhe transparente e punës me të cilën zyrtarët mbrojnë reputacionin e tyre dhe reputacionin e institucionit në të cilin janë person përgjegjës, gjegjësish punonjësit, eliminojnë rreziqet dhe largojnë dyshimet për mundësinë e shfaqjes dhe zhvillimit të korruptionit dhe në këtë mënyrë sigurojnë besimin e qytetarëve në kryerjen e funksioneve publike dhe në punën e institucioneve publike.

Përforcimi dhe ngritja e integritetit është mision dhe përgjegjësi e përbashkët e të gjitha institacioneve në sistem dhe në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Duke pranuar politikën e integritetit, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë merr përsipër që (1) të krijojë një sistem integriteti në institucion, (2) të zbatojë dhe mbështesë sistemin e integritetit dhe (3) të monitorojet dhe raportojë përzbatimin e sistemit të integritetit.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë prezantoi politikën e saj të integritetit para anëtarëve të sektorit privat, shoqërisë dhe qytetarëve, duke u kërkuar atyre, si partnerë në proces, të respektojnë vlerat dhe standartet e vendosura në marrëdhëniet me autoritetet shtetërore dhe institucionet nga sektori publik.

1. Krijimi i një sistemi integriteti

Sistemi i integritetit është krijuar në atë mënyrë që t'u mundësojë autoritetet e shtetërore dhe institucioneve nga sektori publik të punojnë dhe të kryejnë kompetencat e tyre duke respektuar ligjet dhe në përputhje me standartet më të larta etike.

Sistemi i integritetit mbështetet në elementët e mëposhtëm që përfaqësojnë një lloj standardi integriteti:

- Mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
- Pajtueshmëria me kodin e etikës përkatëse në lidhje me pozicionin e nëpunësit;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore bazuar në një sistem meritash dhe kualifikimesh;
- Menaxhimi i qëllimshëm, racional dhe efikas i burimeve publike;
- Transparencë dhe qasje në informacionin me karakter publik;
- Raportimi i mbrojtur nga sinjalizuesit dhe
- Menaxhimi i cilësisë

Mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesit: Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dëshiron që interesat e saj angazhohen se me punën e tyre do t'i jepin përparësi interesit publik mbi interesin privat dhe se do të inkurajojnë dëshirat e zhvillojnë një kulturë organizative që nuk toleron konfliktet e interesit dhe në të cilën përgjegjësia individuale dhe shembulli personal janë bazë për një menaxhim të mirë.

Për të mundësuar menaxhim efektiv të konfliktit të interesit në Ministrinë e Politikës Sociale zbatohet një procedurë për identifikimin dhe deklarimin e qartë të interesave personale, vendosen rregulla të qarta për pritjet e zyrtarëve kur ekziston rreziku i konfliktit të interesit, sigurohet transparencë në procesin e zgjidhjes së situatave në të cilat shfaqet një konflikt interesit dhe zhvillohen mekanizma përmes monitorimin e zbatimit të rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit.

Respektimi i kodit të etikës e cila është e rëndësishme për pozicionin e zyrtarit: Zyrtarët në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë janë të detyruar të respektojnë kodin etik të institucionit në të cilin punojnë, qëllimi i të cilit është promovimi i profesionalizmit, mbrojtjes së interesit publik, llogaridhënieve, përgjegjësisë, paanshmërisë, mosdiskriminimit dhe neutralitetit politik.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë po zhvillon mekanizma që mundësojnë monitorimin e vazhdueshëm të respektimit të kodit të etikës nga zyrtarët.

Për fushat që janë shumë të ndjeshme ndaj korrupsionit, siç janë prokurimet publike, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë miraton gjithashtu kode të veçanta të sjelljes.

Menaxhimi i burimeve njerëzore bazuar në një sistem meritash dhe kualifikimesh: Integriteti promovohet si pjesë e menaxhimit të burimeve njerëzore në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Punësimi bëhet transparent me shpallje publike me kriterë të Menaxhimi i burimeve njerëzore bazuar në sistemin e meritës dhe kualifikimit: Punësimi bëhet transparent përmes një shpalljeje publike me kriterë të paracaktuara dhe politika të zhvilluara që mundësojnë punësimin dhe ngritjen në detyrë në bazë të meritave dhe kualifikimeve dhe parandalojnë ndikimet partiake, nepotizmin dhe kronizmin.

Në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë janë evidentuar pozicione pune të cilat janë veçanërisht të rrezikuara nga korrupsioni dhe për to janë paraparë detyrime të veçanta në lidhje me mbrojtjen e integritetit. Është e nevojshme të respektohen vazhdimisht papajtueshmëritë, ndalimet dhe kufizimet e qenësishme të punës në sektorin publik

Menaxhimi i qëllimshëm, racional dhe efikas i burimeve publike:

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë demonstron çiltërsi, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje në përcaktimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore duke u udhëhequr nga synimi për përbushjen e interesit publik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë merr përsipër që kontratat për prokurimin publik, partneritetin publiko-privat, dhënien e koncesioneve të burimeve shtetërore, dhënien me qira dhe shitjen e tokave dhe pronave shtetërore, etj, do të përmbyllen përmes procedurave transparente që lejojnë trajtimin dhe konkurrencën e barabartë të pjesëmarrësve të interesuar.

Transparenca dhe qasja në informacionin publik: Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë ofron informacion të vërtetë, të duhur, dhe në kohë të plotë për qytetarët dhe personat juridikë, duke respektuar të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë përpinqet për një nivel të lartë të transparencës aktive, d.m.th. publikon sa më shumë informacion në veb faqen e saj dhe demonstron gatishmëri që punët e saj t'i nënshtrohen inspektimit dhe kontrollit publik.

Nëpunësit nuk duhet të përdorin informacionin që disponojnë në kryerjen e funksioneve, kompetencave publike dhe detyrave zyrtare për përfitime për veten ose për të tjeterët.

Raportimi i mbrojtur nga sinjalizuesit: Mundësimi i sinjalizuesve për të raportuar sjellje të palejuesshme ose të paligjshme pa frikën e pasojave është një nga shtyllat për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe sanksionimin e suksesshëm të veprimeve të tilla që kërcënojnë funksionimin e institucionit.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë miraton procedurën për raportim të mbrojtur dhe ka caktuar një person të autorizuar për pranimin e raporteve nga sinjalizuesit. Të gjithë të interesuarit janë njoftuar me procedurën e regjistrimit të mbrojtur dhe personin e autorizuar për regjistrimin e mbrojtur.

Menaxhimi me cilësi: Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë vndos një sistem pune përmes të cilit puna dhe proceset përmirësohen vazhdimesht, zvogëlohen rreziqet dhe kostot, përmirësohet motivimi i punonjësve dhe monitorohen rezultatet e përgjithshme të punës.

Avancimi i ofrimit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve kryhet nëpërmjet planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të përgjegjshëm të proceseve dhe promovimi i një kulture ekselencë në administratën publike, në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 9001, Kuadrin e Përbashkët për Vlerësimin CAF dhe standardet e tjera të cilësisë në sektorin publik.

2. Zbatimi dhe mbështetja e sistemit të integritetit

Për të mundësuar zbatimin efikas të sistemit të integritetit, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë është e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen e të gjithë nëpunësve në proces dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga standardet e integritetit në drejtim të kryerjes ligjore, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente të detyrave të punës.

Strukturat drejtuese në Ministrinë e Politikës Sociale janë përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e sistemit të integritetit, si dhe për promovimin e tyre nëpërmjet sjelljes së tyre personale dhe duke marrë masa për pranimin kolektiv të politikës së integritetit dhe respektimin e saj nga punonjësit.

Ngritura e kapaciteteve bëhet përmes edukimit të rregullt të punonjësve për zbatimin e duhur të standardeve të integritetit përmes trajnimeve, si dhe duke ofruar këshillim për të gjitha dilemat që mund t'u vihen nëpunësve në punën e tyre të përditshme.

Për të siguruar zbatimin efikas të sistemit të integritetit, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë cakton një person për integritet.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë identifikon rreziqet e korruptionit dhe të njëjtat i vlerëson dhe monitoron rregullisht. Prandaj, merren masa për tejkalimin e rreziqeve që kërcënojnë integritetin e institucionit.

3. Monitorimi dhe raportimi për zbatimin e sistemit të integritetit

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë mundëson një sistem në dy nivele të monitorimit të zbatimit të sistemit të integritetit, në nivel të vetë institucionit dhe nga institucioni kompetent, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korruptionit.

Qëllimi i monitorimit të sistemit të integritetit në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë është përcaktimi i efikasitetit të politikave dhe procedurave të aplikuara që mundësojnë zbatimin konsekvent të standardeve të integritetit, si dhe matja e rezultateve të masave të aplikuara për uljen e rreziqeve të korruptionit. Procesi i monitorimit dhe raportimit për zbatimin e sistemit të integritetit koordinohet nga personi për integritet.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë zbaton gjithashtu kontolle të brendshme për të verifikuar zbatimin e standardeve të integritetit përmes përfshirjes së revizionit të brendshëm.

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë merr përsipër të bashkëpunojë me KSHPK-në, duke mundësuar monitorimin e zbatimit të sistemit të integritetit. Për këtë qëllim, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë merr përsipër t'i japë KSHPK-së informacion të saktë, të rregullt dhe në kohë për sistemin e aktiviteteve të ndërmarra në drejtim të zbatimit të sistemit të integritetit, si dhe të zbatojë udhëzimet, rekomandimet dhe indikacionet e marra nga KSHPK në lidhje me përforcimin e integritetit të institucioneve.

MINISTRI
FATMIR HAMANI

